

# Informacione për vaksinën kundër COVID-19

Që nga dhjetori 2020, njerëzit në Zvicër mund të vaksinohen kundër virusit Covid-19. Këtu i gjeni pyetjet dhe përgjigjet më të rëndësishme për vaksinën.

## Kështu mbrohem.

### Vaksina a është e efektshme? Dhe vakina a është e sigurve?

Po. Vaksina kundër virusit Covid-19 është e efektshme. Dhe vakina është e sigurve. Këto fakte u hulumtuan intësisht nga Instituti zviceran për mjete shëruese "Swissmedic". Vetëm pasandaj e ka lejuar vaksinën.

Vaksina u testua me mijëra persona. Hulumtimet tregojnë: Vaksina është e efektshme. Dhe vakina është e sigurve. Gjithashtu për njerëz të moshës së tretë dhe për njerëz me sëmundje të mëparshme.

Vaksina nuk rezulton në efekte të rënda anësore. Ky fakt u vërtetua deri tani nga hulumtimet. Instituti "Swissmedic" në vazhdimësi mbikëqyr sigurinë dhe efektshmërinë e vaksinës.

Me rëndësi: Rreziku për efekte të rënda anësore pas vaksinës është shumë i vogël. Rreziku për një sëmundje të rëndë pas infektimit me koronavirusin është shumë më i madh. Prandaj Enti federal i Shëndetësisë (BAG) e rekomandon vaksinën për persona të veçantë.

### Kush rekomandohet të vaksinohet?

Sipas BAG-së, këto persona rekomandohen të vaksinohen:

1. Persona veçanërisht të rrezikuar si njerëz të moshës së tretë dhe njerëz me sëmundje të mëparshme.  
Me rëndësi: Vërtet gra shtatzëna bien në grupin e personave veçanërisht të rrezikuar. Megjithatë ato nuk rekomandohen të vaksinohen.
2. Personeli i spitaleve dhe i azileve, që ka kontakt me pacientë. Dhe persona, që kujdesin për njerëz veçanërisht të rrezikuar.
3. Persona, që jetojnë në një shtëpi me njerëz veçanërisht të rrezikuar.
4. Banueset dhe banuesit e vendeve të punës, të konvikteve dhe të grupeve të banimit, në të cilat rreziku i infektimit është veçanërisht i lartë. Për shembull të vendeve të punës ose të konvikteve për njerëz me nevoja të veçanta. Dhe gjithashtu personeli i këtyre vendeve të punës, konvikteve dhe grupeve të banimit.
5. Të gjithë të rritur të tjerë, që dëshirojnë të vaksinohen.

Gjithashtu persona, që tashme kanë pasur Covid-19, mund të vaksinohen. Megjithatë ata rekomandohen të vaksinohen vetëm tri muaj pas infeksionit.

**Me rëndësi:** A keni temperaturë të lartë? A jeni i/e sëmurë? A nuk ndiheni mirë? Ose a prisni rezultatin e testit për koronë? Ose a gjendeni në izolim ose karantinim? Atëherë mos e bëni vaksinimin tani. Shtyjeni terminin e vaksinimit. Megjithatë bëjeni vaksinimin mundësisht sa më parë.

## **Kush rekomandohet të mos vaksinohet?**

BAG-ja nuk e rekomandon vaksinën për këto persona:

- Njerëz me një alergji të rëndë për një përbajtës të lëndës së vaksinës (posaçërisht për lëndën Polyethylenglycol (PEG))
- Gra shtatzëna. Deri tani nuk ekzistojnë hulumtime për vaksinën e grave shtatzëna. Prandaj nuk dihet, sesi vakcina ndikon në shtatzëninë. Ose në fëmijën e pa lindur.
- Fëmijët dhe adoleshentët nën moshën 16-vjeçare. Deri tani nuk ekzistojnë hulumtime për vaksinën e personave nën moshën 16-vjeçare. Prandaj nuk dihet, sesi vakcina ndikon në fëmijë dhe në adoleshentë nën moshën 16-vjeçare.

## **Ku dhe kur mund të vaksinoheni?**

Kantonet mbajnë përgjegjësi për vaksinimin. Informacione për vaksinën në Kantonin St.Gallen i gjeni në [www.sg.ch](http://www.sg.ch). Gjithashtu mund ta pyesni mjekun ose mjeken tuaj. Ose mund të pyesni në barnatore.

## **Si zhvillohet vakcina?**

Ju merrni një injeksion në krahun e sipërm.

## **Sa herë duhet të vaksinoheni?**

Nevojiten 2 vakcina. Rekomandohet, që afërsisht 4 javë pas vaksinës së parë ta bëni vaksinën e dytë.

**Me rëndësi:** Bëjini të dyja vaksinat. Vetëm atëherë jeni i/e mbrojtur aq sa mundet.

## **Si mbron vakcina?**

Vaksina e ndihmon trupin tuaj të luftojë virusin. Trupi juaj ndërton një mbrojtje kundër virusit Covid-19. Për këtë gjë, trupit tuaj i nevojiten disa javë.

Afërsisht një javë pas vaksinës së dytë, trupi juaj ka ndërtuar një mbrojtje kundër virusit Covid-19. Që tani rreziku, që ju do të sëmureni me Covid-19, është shumë i vogël.

**Me rëndësi:** Zbatoni edhe pas vaksinës këto rregulla: Lani duart. Mbani një maskë. Dhe mbani distancën. Sepse disa njerëz mund të sëmuren me Covid-19, edhe kur janë vaksinuar. Megjithatë në shumicën e rasteve, persona të vaksinuar nuk sëmuren rëndë.

A dëshironi më shumë informacione për efektin e vaksinës? Atëherë shikoni në faqen e internetit [www.bag-coronavirus.ch/mrna](http://www.bag-coronavirus.ch/mrna).

## **Për sa kohë mbron vakcina?**

Kjo gjë akoma nuk dihet. Megjithatë prodhuesit e vaksinës bëjnë hulumtime për këtë gjë. Ndoshta BAG-ja me kalimin e kohës rekomandon edhe një vaksinim të tretë.

## **A mund të infektoheni me Covid-19 përmes vaksinës?**

Jo. Përmes vaksinës nuk mund të infektoheni me Covid-19. Brenda në vaksinë nuk ndodhen koronaviruset.

## **Vaksina a ka efekte anësore?**

Çdo vaksinë mund të ketë efekte anësore. Megjithatë në shumicën e rasteve, efektet anësore janë të dobëta. Dhe në shumicën e rasteve, efektet anësore kalojnë shpejt.

## **Ç' efekte anësore mund të shfaqen?**

Këto efekte anësore janë të shpeshta:

- Vendi i injeksionit kuqet, dhëmb ose ënjtet.
- dhimbje koke
- lodhje
- dhimbje në muskuj dhe nyje
- simptoma të përgjithshme si ethe ose pak temperaturë

Këto efekte anësore tregojnë, që trupi po e ndërton mbrojtjen kundër virusit Covid-19.

Efekte të rënda anësore janë shumë të rralla. Një efekt i rëndë anësor për shembull mund të jetë një reaksion i rëndë alergjik. Kjo do të thotë, që pas vaksinës shfaqen ënjtje, kuqe, të kruar ose vështirësi frymëmarrjeje. A keni simptoma të tilla? Atëherë ju lutemi, që menjëherë të kontaktoni mjeken ose mjekun tuaj!

## **Për sa kohë mund të zgjasin efektet anësore?**

Normalisht efektet anësore zhduken pas pak ditësh. A keni akoma efekte anësore edhe pas kalimi të një jave? Ose a përkeqësohen efektet anësore? Ose a keni shqetësime? Atëherë ju lutemi, që të kontaktoni mjeken ose mjekun tuaj.

## **Çfarë duhet të bëni pas vaksinimit?**

A e keni marrë vaksinën e parë? Atëherë ju lutemi që drejtpërsëdrejti të bëni një termin për vaksinën e dytë. Rekomandohet, që afërsisht 4 javë pas vaksinës së parë ta bëni vaksinën e dytë.

Me rëndësi: Zbatoni edhe pas vaksinës këto rregulla: Lani duart. Mbani një maskë. Dhe mbani distancën.

## **U vaksinuat. A megjithëse mund t'i infektoni njerëz të tjerë me Covid-19?**

Kjo gjë akoma nuk dihet. Sado ekziston mundësia, që ju me gjithë vaksinimin të merrni një infeksion me Covid-19. Megjithatë ka shumë gjasa, që nuk do të sëmureni. Ose ju do të keni vetëm simptoma të lehta. Por ndoshta mund t'i infektoni njerëz të tjerë me virusin. Prandaj zbatojini edhe pas vaksinimit këto rregulla: Lani duart. Mbani një maskë. Dhe mbani distancën.

## **A duhet të paguani për vaksinimin?**

Jo. Vaksinimi bëhet falas.

## **A bëhet vaksinimi vullnetarisht?**

Po. Në Zvicër vaksinimet bëhen vullnetarisht.

## **A dëshironi më shumë informacione për vaksinën kundër Covid-19?**

Më shumë informacione i gjeni në faqen e internetit të Entit Federal të Shëndetësisë: [www.bag-coronavirus.ch/impfung](http://www.bag-coronavirus.ch/impfung). Gjithashtu mund ta thirrni numrin informues të Federatës: 058 377 88 92.

Ose ju pyesni mjeken apo mjekun tuaj.

Në barnatoren tuaj, ju gjithashtu i merrni më shumë informacione.